



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**

**Psh. nr. 157/22**

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/ L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/ L-092, si dhe nenin 17 paragrafi 3 të Rregullores së Punës së OSHP-së nr. 01/2020, me numër të protokollit 83/2020, pas shqyrtimit të ankesës së “Fatlum Istrefi” me seli në Ferizaj, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Blerja e shërbimëve të konsulencës individuale për nevojat e KK Vushtrri” me numër te prokurimit VUP 644-22-3356-2-2-1, iniciuar nga AK- Komuna e Vushtrrisë, Kryesuesi i Sekretariatit të Organit Shqyrtues të Prokurimit z. Ardian Behra me datën: 25.05.2022, mori këtë:

**VENDIM**

- I. Hedhet si e palejuar** ankesa e “Fatlum Istrefi” me seli në Ferizaj, me nr. të protokollit 157/22, e datës 23 maj 2022, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Blerja e shërbimëve të konsulencës individuale për nevojat e KK Vushtrri” me numër te prokurimit VUP 644-22-3356-2-2-1, iniciuar nga AK- Komuna e Vushtrrisë.
- II. I LEJOHET,** autoritetit kontraktues – Komuna e Vushtrrisë që të vazhdojë më tutje, me procedurat e prokurimit lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Blerja e shërbimëve të konsulencës individuale për nevojat e KK Vushtrri” me numër te prokurimit VUP 644-22-3356-2-2-1.

## ARSYETIM

Organi Shqyrtues i Prokurimit, me datë 23 maj 2022, ka pranuar ankesë nga Fatlum Istrefi me seli në Ferizaj, për aktivitetin e prokurimit me titull: “Blerja e shërbimëve të konsulencës individuale për nevojat e KK Vushtrri” me numër të prokurimit VUP 644-22-3356-2-2-1, iniciuar nga AK- Komuna e Vushtrrisë.

Fatlum Istrefi, me datën 10. 05. 2022, ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim në autoritetin kontraktues. Autoriteti kontraktues me datën 13. 05. 2022 ka refuzuar vendimin e operatorit ekonomik ankues, dhe kundër këtij vendimi për refuzim operatori ekonomik me datën 23 maj 2022 ka parashtruar ankesë në OSHP, mirëpo i njëjti nuk ka paguar tarifën për parashtrim të ankesës dhe në shkresat e lëndës egziston një deklaratë me shkrim ku i njëjti deklaron se nuk ka paguar tarifë për shkak se i njëjti nuk ka para.

Zyra për pranimin e ankesave në OSHP ka tentuar të komunikoj me të për shkak të tarifës, por email që ka lënë në ankesë Fatlum Istrefi ka qenë gabim dhe poashtu nje tjetër email që ka lënë në kërkesën për rishqyrtim ka qenë gjithashtu gabim. Nga zyra për pranim të ankesave është tentuar të komunikojnë edhe përmes telefonit por që të dy numrat që ka lënë në ankesë kanë qenë gabim poashtu.

Organi Shqyrtues i Prokurimit pas analizimit të lëndës, sqaron se ankesa e operatorit ekonomik ankues është parashtruar në kundërshtim me nenin 118 par 1 dhe 2 të LPP-së ku thuhet:

1. Ankuesit duhet të paguajnë një tarifë të ankesave në OSHP vlera e së cilës do të përcaktohet nga KRPP-ja në legjislacionin dytësor. Dëshmia e pagesës duhet ti bashkëngjitet vetë ankesës në përputhje me nenin 111 të këtij ligji. Pagesa do të bëhet në para të gatshme ose në ekuivalent të parave të gatshme në një llogari të hapur nga OSHP-ja në përputhje me Rregullat Financiare.
2. OSHP nuk do të pranojë ankesën nëse tarifa nuk paguhet.

Pra, në pajtim me nenin 118 par 1 dhe 2 të LPP-së dhe sipas nenit 10 të Rregullave për paraqitje të kërkesës për rishqyrtim pranë autoritetit kontraktues, parashtrimin të ankesave pranë OSHP-së, dhe vlera të tarifave të ankesave Organi Shqyrtues i Prokurimit, poashtu

sqaron se operatori ekonomik me rastin e parashtrimit të ankesës nuk ka paguar shumën që ka qenë dashur te paguhet konform vlerës së aktivitetit të prokurimit, andaj, me këtë rast, OSHP konsideron se ankesa është e palejuar dhe si e tillë nuk mund të shqyrtohet.

Kryesuesi i Sekretariatit të OSHP-së, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK – Komuna e Vushtrrisë
- 1x1 OE-“Fatlum Istrefi”
- 1x1 Arhivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ëeb- faqe të OSHP-së

